



POST-DIPLOMIMI DHE TRANZICIONI NË TREGUN E PUNËS

Leadership and Growth Council
www.lgc-ks.org

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Përmbajtja

<i>Për ne.....</i>	<i>2</i>
<i>Hyrje.....</i>	<i>3</i>
<i>Analiza e të dhënave.....</i>	<i>4</i>
<i>Aftësimi Profesional.....</i>	<i>5</i>
<i>Trajnimet dhe Praktikat si metoda të parapërgatitjes profesionale.....</i>	<i>6</i>
<i>Trajnimet.....</i>	<i>8</i>
<i>Pengesat dhe tregu i punës.....</i>	<i>10</i>
<i>Konkluzionet.....</i>	<i>12</i>
<i>Sygjerimet.....</i>	<i>13</i>

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Per ne

Leadership and Growth Council është organizatë jo-qeveritare e themeluar në korrik të vitit 2014, e cila ka për qëllim të nxis dhe të rris udhëheqjen në sektorët e ndryshëm në përgjithësi, me veçanti në edukim dhe ekonomi. LGC është e dedikuar të avancojë mirëkuptimin, praktikën dhe zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe të rrisë pjesëmarrjen qytetare për përfitimet dhe zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi.

“Career Development For Young Women”

-Projekt i mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë¹

Projekti “Career Development for Young Women” është projekt i cili zhvillohet për 12 muaj dhe ka për synim të sigurojë asistencë për zhvillim të karrieres tek vajzat e reja, në mënyrë që ti mundësojë atyre përfshirje në jetën institucionale dhe sociale pas diplomimit. Gratë në Kosovë vazhdojnë të mbesin struktura më e marzhinalizuar, sidomos në sektorin e ekonomisë. Papunësia vazhdon të jetë sfida kryesore për gratë, sidomos për ato që nuk kanë përvojë pune.

Gjatë zhvillimit të implementimit të këtij projekti LGC do të publikoj dy punime që promovojnë kulturën dhe udhëheqjen në zhvillimin e karrierës tek profesionistet e reja.

Ky është publikimi i parë, i cili është pjesë përbërëse e publikimit të dytë që gjithashtu ka të bëjë me zhvillimin e karrierës por me vëmendje tek gratë tashmë në karrierë.

¹ Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, konkludimet si dhe rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) të dala prej analizës së të dhënave dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Autore: Elona Gashi

Maj, 2016

Hyrje

Qëllimi i publikimit

Leadership and Growth Council përmes këtij hulumtimi synon të identifikojë pengesat dhe mundësitë kryesore me të cilat ballafaqohen të sapo-diplomuarit në Kosovë. Ky publikim shërben si kontribut modest për këtë hapësirë midis post-diplomimit dhe tregut të punës. Leadership and Growth Council tenton të analizoj rëndësinë e tranzicionit prej studimeve të larta universitare për në tregun e punës në Kosovë. Pyetjet kryesore të këtij hulumtimi nuk kanë të bëjnë me analizën e tregut të punës në Kosovë si pjesë ndarëse prej Universitetit, në të njëjtën kohë nuk ka të bëjë as me Universitetin në veçanti, por ka të bëjë me ciklin e tranzicionit prej procesit të qenurit studentë në të punësuar. Ky transformim ka qenë objekt i pakët i studimeve të mirëfillta shkencore për të dalluar pengesat kryesore për punësim, megjithëse kohëve të fundit projekte të iniciuara nga organizatat jo-qeveritare dhe së fundmi projekte që veçse janë duke u zhvilluar në Universitetin e Prishtinës² kanë shënuar rritje të interesit për këtë temë. Qëllimi i këtij projekti pra ka të bëjë me zhvillimin profesional të studentëve, mundësitë që i'u ofrohen për pjesëmarrje në të tilla trajnime, si dhe rëndësinë e reformave universitare për plotësimin e kushteve profesionale që kërkon vendi i punës për të cilin kanë studiuar.


Ky publikim për më tepër përpiqet t'i hap rrugë hulumtimeve të tjera më të detajuara dhe me mostër më të gjerë në lidhje me këtë tranzicion, si dhe të shërbejë si burim i besueshëm rreth kësaj çështje.

² Projekte të tjera rreth zhvillimit të karrierës do të përmenden në fq.5 'Trajnimet dhe praktikat si metoda për parapërgatitje profesionale'.

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Analiza e të dhënave

Shumica e të anketuarëve që përfshijnë studentë në bachelor dhe master ende janë në kërkim aktiv të punës. Disa prej tyre kalojnë mbi 6 muaj periudhe kohore në kërkim të punës në tregun e Kosovës pas diplomimit dhe disa nga to më pak se 6 muaj pas përfundimit të diplomimit të diplomimit, ose gjatë kohës së studimeve. Sipas mostrës sonë, e cila përbëhet nga fusha studimi të ndryshme, duke filluar nga drejtimit sociale deri tek ato ekzakte, vetëm 16% e tyre janë të punësuar dhe 56 % e tyre kërkojnë punë në mënyrë aktive³.



Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, numri i punëkërkesve në Kosovë është 273 mijë e 443 persona. Kësaj liste i'u shtohen për çdo vit rreth 6500 persona të diplomuar të papunë⁴.

Fig.1.0

Ky fakt shqetësues kërkon të gjej shkaqet kryesore të kësaj gjendje dhe më pas të mirret me përmisimin e situatës duke zhvilluar teknikat e përmisimit të aftësive profesionale si njëra nga format për luftimin e mos-përgatitjes për tregun e punës dhe reformave universitare si disa nga shkaqet kryesore në performancë për adaptimin në tregun e ndryshueshëm të punës.

³ Fig. 1.0

⁴ Sipas publikimit të Institutit GAP

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Sipas mostrës së zgjedhur⁵, 32% janë duke ushtruar profesionin për të cilin kanë studiuar dhe 52% momentalisht nuk ushtrojnë profesionin për të cilin kanë diplomuar, apo ngjashem me të; (16% hyjnë në të tjera arsye).

Aftësimi profesional

Shkaqet kryesore për mos përgatitjen e studentëve për tregun e punës kanë të bëjnë me ndryshimin e vazhdueshëm të sistemit të tregut dhe kërkimit të aftësive të reja për të zënë punë.




Fig.2.0

Duke u bazuar në këto të dhëna, njohja e gjuhëve të huaja del të jetë shkak kryesor për punësim, sidomos në drejtimet e shkencave sociale, duke pasuar nga rëndësia e posedimit të aftësive menaxheriale dhe atyre të njohjes së aftësive kompjuterike⁶.

Kjo çështje ka ngjallë dilema midis asaj se a mundet dhe a duhet që Universiteti të krijojë kushte të tilla përbrenda, apo këto aftësi duhet të krijohen/përmisohen jashtë kurrikulës? Sipas të anketuarve, në kërkesën për të identifikuar aftësitë kryesore ku kanë nevojë të përmisohen, përgjigjet janë si vijojnë në fig.2.0:

⁵ Kandidatet e përzgjedhura për projektin "Career Development for Young Women"

⁶ Fig.2.0 Kategoritë e aftësive për përmisim

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Identifikimi i këtyre pengesave dhe aftësive kryesore që potencialisht mund të shfrytëzohen për punësim, janë ndër hapat e parë të cilët studentët duhet ti identifikojnë, për të lënë hapësirë pastaj për përmirësime të mundshme.

Trajnimet dhe praktikat si metoda për parapërgatitje profesionale


Në çështjen e përmirësimit të këtyre aftësive dhe dallimit se në çfarë ndryshime kalon tregu, janë të rëndësishme trajnimet dhe praktikat që tentojnë të shërbejnë si parapërgatitje për zhvillimin e tyre profesional.

Për herë të parë, Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës në një projekt të përbashkët me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë së Shqipërisë, kanë filluar projektin e “Punës praktike në institucionet e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës”⁷

Përveç këtij projekti, marrëveshje të tilla janë arritur midis Ministrive të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe Universitetit të Prishtinës, që kanë për synim vendosjen e praktikave si një ndër mundësitë kryesore për përvojë profesionale para hyrjes në tregun e punës. Këtë gjë e ka bërë në janar të këtij viti Ministria e Financave për 600 studentë të Universitetit të Prishtinës, “Hasan Prishtina”. Mirëpo, duke njohur kulturën e angazhimit të praktikantëve në Kosovë, e cila nuk paguhet dhe shpesh herë nuk mbikëqyret profesionalisht, sipas të dhënave që vijnë nga raporti ynë shih (Fig.2.1);

⁷ Programi Kombëtar i Praktikave të Punës (praktika.sociale.gov.al)

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës



54% gjejnë praktikat që i'u kanë shërbyer si parapërgatitje për tregun e punës, 27% nuk i kanë gjetur të dobishme, dhe 18% shohin se kanë qenë të dobishme deri diku.

Fig. 2.1

Praktikat janë të rëndësishme ngase sigurojnë mundësi për të eksperimentuar me zgjedhjen e karrierës që përshtatet me studimet e tyre si dhe me interesat personale. Nëpërmjet praktikave arrihet të shihet zhvillimi i punës profesionale praktike ndaj asaj teorike. Në qoftëse këto praktika janë të mbikëqyrura (mentornship)⁸ atëherë kjo rrit edhe vlerën e tyre duke i angazhuar në projekte, takime si dhe punë praktike të përditshme, për t'i mundësuar përvojë më të qartë të pritshmërive pas studimeve.


⁸ "Career Development for Young Women" momentalisht është duke zhvilluar fazën e dytë të projektit që përfshin praktikat (Internship dhe Mentorship)

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Trajnimet

Në mostrën e përdorur për anketim marrin pjesë kandidatet e përzgjedhura të projektit “Career Development for Young Women” të cilat përvec këtij programi, 76% e tyre nuk njeh programe tjera të ngjashme; 7.7% njohin programe tjera të ngjashme (15% ka të bëjë me arsyet tjera të informimit). Çështja e mos-informimit dhe mos inicimit ka të bëjë me faktor të ndryshëm. Universiteti i Prishtinës së fundmi ka filluar projektin e parë që prek këtë çështje drejtpërdrejtë. Qendra për Zhvillim të Karrierës e cila prezanton aktivitetin “Prezantimi i kompanive-diskutim rreth kriterëve të tregut të punës në Kosovë” synon të shërbej si mundësi praktike dhe ta hap diskutimin për njohjen e kriterëve për punësim.

Fig.3.0



Kjo çështje ka qenë pjesë e rëndësishme e raportit për identifikim, duke u përfshirë edhe në pyetësor, për të ndihmuar në gjetjen e mundësive për përmirësim nga Universiteti i Prishtinës. Kështu në qëndrimin e paraqitur: ‘Trajnimet për parapërgatitje në tregun e punës duhet të inicohen nga fakulteti përkatës’;

53.8% pajtohen me këtë qëndrim dhe 46% pajtohen plotësisht. Pra të gjithë të anketuarit pajtohen për inicim të trajnimeve brenda drejtimeve të tyre, dhe jo domosdoshmërisht jashtë Universitetit.

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Rreth 3730 persona janë punësuar me anë të ndërmjetësimit të zyrave të punës dhe mbi 1600 persona kanë përfitur nga programet e trajnimit të organizuara nga 8 qendra të trajnimit profesional⁹. Studimi i vitit 2001 i Institutit Riinvest tregon se ka një kërkesë shumë të madhe nga ana e bizneseve për rritje të trajnimeve dhe mbi 80 % e bizneseve ishin të gatshme të paguanin për të¹⁰.




Fig. 3.1

Shumë nga të sapo diplomuarit, të cilët kanë gjetur punë në periodha të shkurtëra kohore pas diplomimit e kanë gjetur veten si deri diku të përgatitur për tregun e punës (52%), dhe disa mjaftueshëm të përgatitur për

tregun e

punës (48%).

⁹ Tregu i Punës dhe Papunësia në Kosovë, raport hulumtues; Riinvest Institute, janar 2003, rishikuar më 2004.


¹⁰ Tregu i Punës dhe Papunësia në Kosovë, raport hulumtues; Riinvest Institute, janar 2003, fq.35-1.4.4

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Pengesat për të hyrë në tregun e punës

Për të arritur një pasqyrë më të qartë të reflektimit mbi pengesat kryesore të punësimit në Kosovë, sipas analizës së të dhënave del se gjatë periudhes së kërkimit të punës nga kandidatet e anketuara, ato kanë hasur në këto pengesa. (fig.4.0)

Sipas këtyre të dhënave del se, mbingarkimi në pozitat publike dhe private është arsyeja




kryesore në mos qasjen e studentëve në tregun e punës, ngase pozitat veçse janë të zëna dhe nuk ka nevojë për kuadro të reja. Ky problem i ka rrënjët thellë në sistemin e edukimit dhe informimin e saktë që nxënësit duhet të kenë pasi të kryejnë shkollën e mesme dhe para se të vendosin për studime universitare.

-Pra analiza e tregut të punës dhe informimi i saktë për drejtimit në

universitet janë disa prej arsyeve që do të mund të parandalonin mbi-ngarkimin në disa drejtime dhe mungesën e dukshme për profesione të tjera.

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës



Lidhur me këtë çështje, e cila poashtu është adresuar në procesin e anketimit, në pyetjen se: 'Sa ka hapësirë punësimi për profesionin e juaj?':

Shumica mendojnë se ka hapësirë punësimi për profesionet që kanë zgjedhur për të studiuar (52%), si dhe 26% mendojnë se ka shumë pak hapësirë punësimi.

Fig.4.1

Zgjedhja për drejtimin e studimeve universitare duhet të jetë zgjedhje e cila bazohet në informim të saktë mbi statistikat dhe raportet mbi tregun e punës, mundësitë e punësimit si dhe aftësi profesionale që mund ti përvetësoj përmes drejtimit të përzgjedhur.

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Konkluzione / Rekomandime

1. Zhvillimi i aftësive profesionale mbetet ende çështje e cila adresohet prej të dy palëve, punëdhënësve dhe të punësuarëve. Këto aftësi janë kritere kyçe në punësim. Andaj, trajnime të tilla profesionale të cilat mund të inicohen nga ministritë relevante, universiteti ose ojq-të, luajnë rol të theksuar në motivimin e potencialit të punonjësëve të ri në adaptimin e tregut të punës.
2. Rëndësia e adresimit të çështjes së *aftësimit profesional* nga fakultetet pëkatëse, si burim i këtij tranzicioni dhe urëlidhëse me kompanitë, qofshin ato private apo publike.
3. Mundësia e zgjedhjes së lëndëve zgjedhore dhe përmisimin e syllabuseve për t'iu përshtatur kërkesave të punës dhe aftësive më të reja që kërkohen në tregun e ndryshueshëm të punës.
4. Informimi i saktë dhe me i përhapur në shkollat e mesme rreth drejtimeve universitare si dhe kuadrot e mbi-ngarkuara në drejtime të caktuara.
5. Mundësia e përmisimit të zhvillimit të praktikave në Institucionet e Republikës së Kosovës si formë e parapërgatitjes për tregun e punës.

Post-diplomimi dhe Tranzicioni në Tregun e Punës

Sygjerime

Të anketuarve gjithashtu u kërkua të sygjerojnë përmisime në syllabuset/lëndët që ato mendojnë se i shërbejnë dhe janë më të dobishme profesionalisht, varësisht prej degës së studimit të tyre. Kështu në këtë pyetje komentet dhe sygjerimet qasen drejtpërdrejtë funksionimit të fakulteteve dhe mundësive që ato japin për zhvillim profesional brenda kurrikulave të tyre.

Sipas sygjerimeve për përmirësim:

- a.) Juridik: Inkuadrimi i lëndëve praktike si dhe simulimeve të llojeve të ndryshme që kanë të bëjnë me përvojën e drejtpërdrejtë të gjyqeve, mbrojtjes si dhe prokurorit.
- b.) Juridik: a.) literatura nuk është e përditësuar me zhvillimet e fundit në botë, shumica nga këto libra kanë qenë të bazuara në ligje që kanë ekzistuar më parë dhe që nuk janë në fuqi më. b.) nevoja e zhvillimit të mendimit kritik gjatë ligjëratave.
- c.) Të ketë më shumë orë ligjëruese dhe praktike rreth metodave të hulumtimit¹¹.

Rreth publikimit

Ky punim tenton të hap rrugë për hulumtime tjera më të detajuara dhe me mostër më të gjerë në lidhje me këtë tranzicion, si dhe të shërbejë si burim i besueshëm i referencës rreth kësaj çështjeje.

Ky punim është pjesë përbërëse e projektit “Career Development for Young Women” si dhe pjesë e publikimit të dytë nga LGC i cili zhvillon temë të njëjtë por zhvillohet me intervista kualitative me gratë në karrierë.

¹¹ Këto qëndrime dhe sygjerime janë të studentve që momentalisht janë duke zhvilluar studimet në Universitetin e Prishtinës, dhe nuk paraqesin drejtpërdrejtë rekomandimet përfundimtare të këtij publikimi.